



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME Nr. 2 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 28/08/2018

Nga: Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë.

Drejtuar: Shoqërisë “RESULI-ER” sh.a, me NUIS L12510413V dhe me adresë:
Lagjja Mbrostar Ferko, rruga "Baltës" banesa nr-53, Fier.

Procedura e prokurimit: Kërkesë për Propozim.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-81804-08-02-2018.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje solari”, afati: **Nga nënshkrimi i kontratës deri më 31.12.2018.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 31, Date 06.08.2018.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. **Operatori Ekonomik “TRIOS” sh.a me NUIS L12805203J me çmim total i ofertës i paraqitur në marzh fitimi: 9.9 % (nëntë pikë nëntë).**
2. **Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “RESULI-ER” sh.a me NUIS L12510413V me çmim total i ofertës i paraqitur në marzh fitimi: 28 % (njëzet e tetë).**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **“TRIOS” sh.a me NUIS L12805203J**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- a) Nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit pasi nuk ka dorëzuar vetëdeklarimin me shkrim sipas Shtojcës 5 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”.
- b) Nuk plotëson pikën 2.2.3 të kapacitetit ekonomik dhe financiar pasi vërtetimi për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2018 nga Bashkia e Tiranës nuk është paraqitur në formën e kërkuar.
- c) Nuk plotëson pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik pasi në licensën për tregëtimin e solarit, lëshuar nga QKL-ja në rubrikën ku shënohet vendi i kryerjes së veprimtarisë është shënuar adresa fshati Balldre, Papër, Elbasan ndërkohë që kjo adresë në ekstraktin e QKR-së figuron e mbyllur që në datë 02.04.2015.

- d) Nuk plotëson pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik pasi nuk ka paraqitur akt pronësie ose kontrate qeraje ose të jetë pasqyruar në ekstraktin e QKR-së, Vertetim teknik nga ISHTI ose organ i autorizuar, Akt-Teknik nga PMNZH dhe Policë Sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri për vendin e ushtrimit të aktivitetit të tregëtimit me shumicë të solarit për të cilin është licensuar nga QKL-ja, përkatësisht fshati Balldre, Papër, Elbasan.
- e) Nuk plotëson pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik pasi në lejen mjedisore si vend të ushtrimit të aktivitetit figuron adresa fshati Sharrë, Vaqarr, Tiranë, adresë e ndryshme nga ajo e deklaruar në licensen e tregëtimit me shumicë leshuar nga QKL-ja e cila është në fshatin Balldre, Papër, Elbasan. Si rrjedhim OE nuk ka paraqitur leje mjedisore për vendin e ushtrimit të aktivitetit për të cilin është licensuar për të ushtruar aktivitetin e tregëtimit me shumicë të solarit.
- f) Nuk plotëson pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik pasi boti i paraqitur nga operatori ekonomik është me kapacitet më të madh (28.000 litra) se kapaciteti i kërkuar (deri në 20.000 litra) .
- g) Nuk plotëson pikën 2.3.7 pika a) të kapacitetit teknik pasi nuk ka paraqitur ADR - në e çisternës së mjetit me targë ADR 111.
- h) Nuk plotëson pikën 2.3.7 pika d) të kapacitetit teknik pasi nuk ka paraqitur deklaratë nga administratori i shoqërisë për verifikimin dhe kontrollin në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës së mjeteve të operatorit ekonomik nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Shoqërinë **“RESULI-ER” sh.a me NUIS L12510413V** me adrese Lagjja Mbrostar Ferko, rruga "Baltës" banesa nr-53, Fier, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme në marzh fitimi prej: **28 % (njëzet e tetë), është identifikuar si ofertë e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, Rruga 5 Maji**, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 20.08.2018.

Ankesa: Nuk ka.